

VENDIM
Nr. 192, datë 6.3.2013

**PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS DHE
PROJEKTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE, FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH) DHE KfW FRANKFURT AM
MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PROGRAMI RURAL
I FURNIZIMIT ME UJË (FAZA 2)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 10 080, datë 23.2.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi rural i furnizimit me ujë (faza 2)”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rishpërndarjes së fondeve sipas marrëveshjes së huas dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi rural i furnizimit me ujë (faza 2)”, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha